



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 37

Datë: 06. 07. 2017, ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Eshref Vishi, anëtarë i KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.**
 - 2. Njoftim lidhur me vendimet e PZAP-it.**
 - 3. Të ndryshme.**
-

1. Hyrje: Kryesues i mbledhjes, z. Eshref Vishi, anëtar i KQZ-së.

Eshref Vishi: Të nderuar anëtarë të komisionit të zgjedhjeve zyrtarë të komisionit në bazë të autorizimeve të kryetares, të dispozitave të rregullores të punës së komisionit zgjedhor, të mbledhjes së komisionit do ta drejtoj unë. Nga 11 anëtarë të komisionit prezent janë 8, andaj konstatoj se ka korum të nevojshme për fillimin dhe vazhdimin e mbledhjes për sot e kemi vetëm një pikë të rendit të ditës. Kjo ka të bëjë me njoftimin lidhur me njoftimin e PZAP. Para se ta hapi shqyrtimin e komisionit kërkojmë nga administrata një prezantim për piken e rendit të ditës. Në pika të shkurta për përmbajtjen e PZAP.

Enis Halimi: ZAPI e ka marrë vendim të cilin e kemi pranuar para disa minutave. Sikur mund ta shihni pranohet në disa prej ankesave e një subjekti politik dhe me cilën ne urdhërohem që të procesojmë me rinomërim me disa kuti për dy komuna, konkretisht në komunën e Fushë Kosovës dhe të Suharekës. Vendimi është paralelisht. Faleminderit!

Eshref Vishi: Unë konstatoj nga vendimi shihet se kemi të bëjmë me 2 subjektet politike. Një është “Kosovski Nëmi Romani”, partia në seli në Prizren si dhe subjekti tjetër politik është “Partia Rome e Bashkuar e Kosovës”, gjithsej 2. Kërkohej rinomërim në dy komuna që ka të bëjë me komunën e Fushë Kosovës në 12 vendvotime, ndërsa komuna e Suharekës me 11. Gjithsej, janë 23 vendvotime. Hapi diskutimin për rendin e ditës. Nëse dëshiron dikush le të merr fjalën?

Adnan Rrustemi: Pa e diskutua vendimin që është e vërteta, unë vetëm po ndalem te urdhërimi ose supozimi i PZAP-s që thotë që te numërohen votimet e këtyre 2 subjekteve politike dhe që sekretariati le ta bart kryeshefi dhe koordinatori i QNR-s vërtet që t`ia numëroj vetëm këtyre 2 subjekteve votat dhe mos të lëshohet jashtë këtij vendimi. Nëse eventualisht vëren se duhet të na njoftoj paraprakisht të koordinatori i QNR-s unë nuk e pranoj dhe nuk e di pse duhet ne as një votë e vetme me ju larguar një subjekti politik që nuk është këtu e një vendimi le t`i numëroj votat e këtyre dyave

Betim Gjoshi: Ne, them se nuk jemi edhe me faj edhe ne vet si institucion. E para jo gjithmonë po jepen përgjigjet e profesioniste që ka kaluar ne komisionin qendror sa i për komunikimit me organe tjera qysh janë ZAPI edhe Gjykata Supreme. Faktikisht nuk kemi fare komunikim për me koordinuar ata është e kuptueshëm që nuk janë në procesin, por po ka edhe ne brenda neve që nuk po ka dhe po japin orientime të gabuara. Më ka ardhur keq për sot, që ne 11 ora ka marr gjykata vendim e premë për sot, ndërsa 12 ora, PZAP e ka pas vendimi e shkruar për me ia aprovuar vendimin. Me një informatë jo zyrtare kemi marrë vesh edhe me insistimin tonë që duhet 12.30 me na jap përgjigje. Për ata në ora 1 që t`ju vjen përgjigja e saktë për dokumentet prej QNRS-s që i kanë vërtetuar që nuk është ankesa e bazuar. Pra, këto llogaritjen që i kanë bërë sot me një faqe të thjesht nuk është marre që ata i kanë llogaritur për 2 vota ma shumë dhe 2 vota ma pak dhe përputhen me vota me kusht, se prapë nuk i ke te humbur këto vota me kusht fare ose janë kuti që janë të rinumëruar.

Unë, tha z. Gjoshi, nuk dua me besuar se ndoshta një të realitet është qysh ka bo ankuesi le që janë te pa afatshme vendi jo serioze njeri kur lyp për 23 kuti për 30 minuta me kthyer përgjigje. Mos është institucion plus kur e ki përball që ata kanë edhe një vendi, se kanë pas kurrgjë për ngut edhe për me marrë për te njëjtin kohë na prapë nesër këna me u ul edhe me marr një vendim tjetër për rinomërim te kutia të tij, ajo çka është. Për mua kryesore është si anëtarë i komisionit zgjedhor mendoj se i ka humbur besimi këtij procesit 3 deputet i kemi bërë dje kjo mundet me na prodhuar edhe një parti tjetër se ishin 5 vota diferencë nesër mundet me na prodhuar edhe një deputet tjetër. Çka m`i thanë edhe kujt duhet mej besuar. Këtu është problemi kjo është absurd në qoftë se edhe krejt kutit ne QNR mej numri edhe para se me dhanë një rezultat por mbas rezultati përfundimtar me u kthyer e me u marrë me vend edhe kjo është me kundërshtim me ligjin na po i ndihmojmë PZAP-s apo, ne kushte normale është dashur që ti ndihmoj se qysh me aplikuar këtë vendim, s`e ky është vendim koti dhe as vendimi i gjykatës supreme nuk i jep kurrfarë argumenti të tyre. Për shembull na po e marrim si një vendim për

me i numëruar. Unë me kanë i këtij subjekti politik kisha ankimuar nëpër këto komuna ku ka provuar ZAPI se me të njëjta argumente në këto komuna si me, me nga një fletë kompjuteri llogaritë. Kaq vota i ka pas, së pari një komunë prej Fushë Kosovës vetëm 11 vend votime. Për me ja jap rezultatin ma të madh edhe me të vogël ka more komuna ma shumë se vendvotime. Dhe nuk guxon me leshu ZAPI ne matematik të tilla në një institucion. Unë e kam pa edhe e kam dëgjuar Xhemen duke dialogu me ta edhe duke ja shpjeguar ata ishin këmbëngulës se votat me kush duhet me vendos me vendvotim te rregullt për ata as nuk e dinë se çka është dengu as krijimit dengut edhe as që donë me u interesua me u procesuar ajo far punë na edhe dje e kemi pa brenda institucionit, ka pasur probleme duke i pasur këto raste të kutive me kusht a çka ke tash me të vërtetë ka pasur.

Ne, tha z. Gjoshi, s`kemi çka me u ndalur na duhet me ju jap sa ma shpejt Burimit, por edhe një send duhet me qitur vendimin për rinumërim e këtyre kutiave tonin edhe pse jemi urdhëruar edhe kemi detyrë me urdhëruar në QNR se me hi ne ueb faqe. Nuk po mundemi me gjatë këto vendime edhe u dashtë me pas edhe një data bazë të krijuar se jemi duke i rinumëruar disa herë vendvotime. Nuk është jo serioze edhe për ne na ja kemi nisur jo seriozitet për rinumërim te pjesshëm, s`e nuk janë proceduar as në ligj as te QNR-së edhe në numrin e pjesshëm. Po vazhdojmë ma tutje edhe une jam sikur Adnani. Unë e pash edhe atë ditë se u dashke me i numëruar do se kish shumë se thojshin me i rinumëruar votat e kandidatëve të PDK-së. I kishin pasur 300 vota te vlefshme e i kishin dalë 293. A je t`u kuptuar? Nuk u përputhke për parti. Pa qare u dashke me i numëruar krejt e krejt partitë e tjera. Dhe dallimin, ama ata nuk kishin pasur vota të pa vlefshme të kandidatëve që kanë pasur mirëkuptim. Atë farë komisioni që kanë bërë pazar për fat të keq neve po na dalin shumë. Nuk po besoj që me na hup që ky mandat, me u marrë ky vendim. Edhe një, ai nesër se çka ju thojmë opinionit për me u mbyllur. Edhe shumë seriozisht po them jam që 10 vjet anëtarë i komisionit nuk ka ndodh kjo vjedhje votave për 20 %, por kemi ditur me orientuar. Fajtori u kanë brenda afatit ligjore janë marr masa duke shkuar ne zgjedhje ne krejt komuna, por me te shkuar 100% te procesit zgjedhor edhe me u deformuar prej ditës që kryet pa fajin e KQZ-s se. Unë po them prapë deri ne fund kjo është tmerr na nuk po dimë qysh me reagu. Valmiri na pyeti a të presim të këtyre mbledhjeve ose çka ki me than para mediave ose çka me than ne këtë rast para mediave kur mundemi na pra mej than Opinionit se kur mundemi na mej certifikuar zgjedhjet. Mos harroni se këto janë vendime prapë të shkalles se parë, si prej atij që hup dhe si prej ati që nuk humbë. Kështu që ndoshta deri ka viti i ri..

Eshref Vishi: Nuk është kjo mes PZAP-s dhe Gjykatës Supreme...?

Betim Gjoshi: Gjykata Supreme e ka kthyer në PZAP, se PZAP u dashtë me u kanë shumë korrekt se as ne here e parë nuk ka qenë edhe nuk na ka vet neve për këtë landë. As tash pa na vet e kish marr vendimin pa pika qendrore te njëjtit vendim ama si ka marr për bazë çka i kanë dërguar, se prapë këtë vendimin ku janë 9 vota 9 janë nuk janë 11. 9 i kanë edhe ne sajt zyrtar në forma elektronike. Në të gjitha se hyra me shikuar edhe vet se d.m.th mu dasht me u marr me at far pune se tash ne dorën zemër ne mundemi me u dalë tash tjetër gjë, por na po flasim për çka po akuzohemi nuk ka pasur ndryshim, por hajde vazhdojmë, ja numërojmë deri ne pranverë a verë...

Eshref Vishi: Vendimi i PZAP-s, është obligative për Komisionin e Zgjedhjeve, s`na pëlqen me ato që

kërkohet por, ne duhet ta zbatojmë, është një vendim që duhet te merret. A ka dikush që dëshiron ta merr fjalën...?

Betim Gjoshi: Jo zotëri Eshref se nuk është ajo se m'u p.sh, nuk me intereson vendimi i PZAP-s. E para, ne të gjithë jemi te bindur se, është jashtë afatit edhe janë kanë krejt vendimet te ato tjerat ne kushte normale na është dashtë me menduar me apeluar këtë vendim janë këto institucione mbi neve, edhe po na i deformojnë punën tonë dhe po na devalvojnë. Këtu, është problemi na po merremi jo me vendimin sot konkretë ky vendim ka mujtë me u kan ni parti tjetër por ne çka dojmë me thanë se ZAPIT krejt vendimi çka i ka marr janë te gjitha jashtë afatit me të njëjtat argument ne mendojmë ndryshe sot ndryshe por pjesërisht ndryshe por vetëm, për me nxjerr vetëm dhe s'ka marr as një dëshmi që ju kanë dërgu, këto po e themi unë si ka lyp herën e par, nuk e pash as që ka shkrujtë dikush për me marr dëshmi prej neve d.mth., që e ka marrë këtë vendimin ne qatë drejtim edhe më, nuk janë kthyer për me i shiku dëshmitë a po kupton çka po them se kjo është se mu. Valdeta më ka thanë se në 12 ora ata, kanë filluar kështu që, janë ngut shpejt e shpejt. Por, kanë hy në konflikt ma te madh interesi...Kryetarja e PZAP-s, është kryetarja e Gjykatës Supreme...Kjo, është tmerrri i botes! Por, të vazhdojmë ne, të mos e vanojmë QNR-n...

Enis Halimi: QNR, ka thirrë stafin me fillim ne orën 17, dhe po besoj se, sa më shpejt kanë me i krye dhe se ata janë në përgatitje. Atje, është duke vazhduar procesi normalisht.

Binak Vishaj: Është edhe një vendim tjetër i Panelit Zgjedhor, a kanë kohë... deri kur, sepse janë dy vendime që i ka pranuar panelit zgjedhor. Atëherë, a planifikohet për me mbajtë sonte një mbledhje për rezultatet e QNR-së...?

Sami Hamiti: Nëse përfundon procesi i numërimit, është mirë ta presim vendimin tjetër...!

Eshref Vishi: Të mos prejudiojmë se çarë vendime bjen PZAP, por t'ecim përpara me vendimet tona...

Betim Gjoshi: Lidhur me këtë vendim, ne duhet me i marr do hapa, ja krijon ndryshim ose ka me nxjerrë rezultate të njëjta...Ne, duhet prapë rezultatit me këqyrë për këto dy parti, me shiku a ka pas ndryshim a s'ka pas në këto kuti...Ne, ose duhet të mbajmë mbledhje, ose duhet me e lëshuar një komunikatë...

Eshre Vishi: Nëse duhet një votim formal, lidhur me obligimet që i merr KQZ dhe, QNR të fillojë procesin e numërimit duke pasur parasysh vendimin e PZAP-së...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan vendimin që QNR të fillojë me procesin e numërimit...

Për KQZ

Eshref Vishi, anëtar i KQZ
